



**AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT, Prishtinë**

**NJOFTIM**

Ky njoftim publikohet me qëllim të informimit të palëve të cilët kanë paraqitur kërkesë për blerjen e banesës pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (“ Agjencia”), dhe me të cilët ka qenë i përealizueshëm komunikimi përmes postës.

Agjencia, bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1, të Ligjit për Shitjen e Banesave mbi të cilat Ekziston e Drejta Banesore Ligji Nr.04/L-061, ka mandat për shitjen e banesave në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Pas shqyrtimit të dëshmimeve dhe dokumentacionit në dispozicion të bashkangjitura kërkesës së palëve për privatizim të banesave, Bordi i Agjencisë me Vendimin **Nr.Ref.BD-737/7** vendosi si në vijim:

**Agjencia shpallet jokompetente për ti shqyrtuar kërkesat e poshtëshënuara, pasi që subjektet të cilat i kanë ndarë banesat në shfrytëzim nuk janë ndërmarrjet shoqërore dhe nuk bien nën jurisdikcionin administrativ të Agjencisë.**

**DETAJE LIDHUR ME KËRKESAT PËR BLERJEN E BANESËS**

1. Numri i kërkesës të paraqitur pranë Agjencisë **3831**-Bartësi i së drejtës banesore Misko Bulatovic, ka paraqitur kërkesë për privatizim të banesës e cila iu është ndarë në shfrytëzim nga “ **Komesariati për Refugjat i Republikës së Serbisë**”
2. Numri i kërkesës të paraqitur pranë Agjencisë **6281**-Bartësja e së drejtës banesore Marta Ratkovic, ka paraqitur kërkesë për blerjen e banesës e cila iu është ndarë në shfrytëzim nga “ **Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë**”

3. Numri i kërkesës të paraqitur pranë Agjencisë **7851**-Bartësi i së drejtës banesore Miodrag Jovanovic, ka paraqitur kërkesë për blerjen e banesës e cila iu është ndarë në shfrytëzim nga **“Administrata Doganore”**.
4. Numri i kërkesës të paraqitur pranë Agjencisë **7586**- Bartësi i së drejtës banesore Azem Muqolli, ka paraqitur kërkesë për privatizim të banesës e cila iu është ndarë në shfrytëzim nga **“ Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit e Veprimtarive Komunale, Banimet dhe Mbrojtjes së Ambientit të Njeriut në Mitrovicë”**.

**Shënim i rëndësishëm:**

Pala e pa kënaqur me Vendimin e Bordit, udhëzohet që ti përdor mjetet juridike pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 30 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 04/L-034) dhe nenin 6 paragrafi 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (Ligji nr. 04/L-033).